



RAPORT MBI RERALIZIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK

me rastin e Projekt Vendimit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025

Me Konkludimin Nr.: 01-400/25-6114/1 të datës 18.08.2025, Kryetari i Komunës së Tuzit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Vendimin për Pjesëmarrjen e Popullatës Lokale në Kryerjen e Punëve Publike, ka hartuar Projektvendimin mbi Ndryshimet në Vendimin për Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025 me Programin e Diskutimit Publik, i cili u publikua në faqen e internetit të Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me dhe iu dorëzua kështilltarëve të Kuvendit të Komunës së Tuzit, si dhe kryetarëve të bashkësive lokale.

Projektvendimi mbi Ndryshimet në Vendimin për Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025 u vu në diskutim publik për një periudhë prej 15 ditësh, duke filluar nga data 22.08.2025 dhe duke përfunduar më 05.09.2025. Sipas programit të përcaktuar, seanca publike qendrore u mbajt në ambientet e Kuvendit të Komunës së Tuzit, më 05.09.2025, duke filluar nga ora 10:00.

Diskutimi publik në formë elektronike, me shkrim dhe me gojë u zhvillua nga Komuna e Tuzit. Gjatë diskutimit publik, qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë iu dha mundësia të shprehnin pikëpamjet e tyre në formë të shkruar, elektronike dhe me gojë.

Përfaqësuesi i përpiluesit ishte z. Driton Gjokaj, Sekretar i Sekretariatit për Financa, i cili bëri një prezantim hyrës mbi Draftin e vendimit përkatës. U sqarua se Projektvendimi për ndryshimet në Vendimin mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025 është përgatitur në bazë të Nenit 8 të Ligjit për Buxhetin dhe Përgjegjësinë Fiskale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 20/14, 56/14, 70/17, 04/18 dhe 55/18, 66/19 dhe 70/21, 027/23, 125/23, 11/25), Nenit 31 të Ligjit për Financimin e Vetëqeverisjes Lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 03/19, 086/22, 005/24, 007/24), Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 02/18, 34/19 dhe 38/20, 84/22), Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" - dispozitat komunale Nr. 24/19, 05/20, 51/22, 55/22).

Propozimi i Vendimit mbi ndryshimet në vendimin për Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025

Diskutimet e pjesëmarrësve në diskutimin publik:

Z. Driton Gjokaj, Sekretar i Sekretariatit për Financa, i njoftoi pjesëmarrësit me Projektvendimin mbi ndryshimet në vendimin për Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025, dhe prezantoi përmbajtjen e vendimit. Ai i ftoi pjesëmarrësit të pyesnin për çdo gjë që u intereson atyre, duke theksuar mundësinë e paraqitjes së sugjerimeve dhe komenteve në arkivin e Komunës, si dhe përmes email-it.

Gjatë diskutimit publik qendror, nuk pati sugjerime ose komente nga pjesëmarrësit.



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për financa
Sekretarijat za finansije
Nr./Br. 05-400/25-6114/5

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 152
finansije@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 10.09.2025. godine

Lidhur me Projektvendimin për ndryshimet në Vendimin mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2025, subjektet e mëposhtme paraqitën komente, sugjerime dhe opinione (lidhur me pjesën aktuale të buxhetit) me shkrim dhe me anë të email-it brenda afatit të përcaktuar:

Subjekt	Vërejtje sugjerim/koment	Pranohet/Refuzohet
“doo Komunalno / shpk Komunale” Tuz-i	Rritje e transfertave për Komunale shpk në shumën prej 150,000.00 eurosh	Pranohet pjesërisht, në përputhje me mundësitë e komunës
Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale i Komunës së Tuzit	Rritje e shërbimeve të tjera - organizimi i Pazarit të Dimrit 100,000.00 euro Rritje e transferit për KF Deciq - 97,000.00 euro Rritje e transferit për KB Deciq - 15,000.00 euro	Pranohet.

Sekretar
Driton Gjokaj

